

URDHËR
Nr. 74, datë 2.3.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”; si dhe autorizimit nr. 1101/2, datë 17.2.2023, “Autorizim për shërbim jashtë vendit”, referuar vizitës zyrtare të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit në Berlin, në Republikën e Gjermanisë,

URDHËROJ

1. Znj. Vilma Bello, zëvendësministër i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të zëvendësojë për kohësisht znj. Mirela Kumbaro Furxhi, ministër i Turizmit dhe Mjedisit në ushtrimin e kompetencave të saj.
 2. Ky urdhër i shtrin efektet e tij nga data 6.3.2023 deri në datën 9.3.2023.
 3. Ngarkohet Zyra e Arkiv-Protokollit dhe të gjitha drejtoritë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi